



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

V E N D I M

PËR DHËNIE AUTORIZIMI PËR NDRYSHIMIN E VENDNDODHJES SË QV-SË NR 0990, BASHKIA KLOS, PËR ZGJEDHJET PËR ORGNET E QEVERISJES VENDORE, TË DATËS 30 QERSHOR 2019

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e tij të datës 26.06.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI -	Anëtar
Edlira	JORGAQI -	Anëtare
Rezarta	BITRI -	Anëtare

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për dhënie autorizimi për ndryshimin e vendndodhjes së QV-së nr 0990, Bashkia Klos, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, gërma "a", neni 62, pika 4, neni 93, pika 2, gërma "a", të Ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur si dhe dëgjoji diskutimet e të pranishmëve,

V E R E N

Prefekti i Qarkut Dibër, me shkresën nr. 12383, datë 26.06.2019, informon se nga ngjarjet e datës 19 qershor, është dëmtuar objekti ku ishte caktuar QV nr. 0990, biblioteka e qytetit.

Në kushte të pamundësisë që ky objekt të funksionojë si Qendër Votimi, Prefekti paraqet kërkesën që kjo QV të caktohet në ambientet e spitalit Klos, me vendodhje përballë bibliotekës së qytetit.

Gjithashtu edhe KZAZ nr.17, Bashkia Klos, në përmbushje të detyrës, ka informuar për pamundësinë e funksionimit të ambientit të Bibliotekës së Qytetit si Qendër Votimi, për shkak të dëmtimeve të shkaktuara gjatë ngjarjeve të datës 19 qershor. Në këto kushte KZAZ 17 propozon që QV nr.0990 të caktohet në ambientet e spitalit Klos.



PËR KËTO ARSYE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 23, pika 1, gërma "a", nenin 62, pika 4, neni 93, pika 2, gërma "a", të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar,

V E N D O S I :

1. Dhënien e autorizimit për ndryshimin e vendndodhjes së QV-së 0990, duke e caktuar në ambientet e Spitalit Klos.
2. KZAZ nr. 17 të publikojë menjëherë listat e zgjedhësve në vendndodhjen e qendrës së votimit nr. 0990, caktuar me këtë vendim.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda pesë ditëve nga shpallja e tij.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI	Anëtare

